



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. Prot.

Vlorë, më 27.04.2018

Vendim
Nr. 6, datë 27.04.2018

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PUNËSIMIT TË PERSONELIT NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE SEKTORIN E AUDITIT NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Bazuar në nenin 49/f të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 27.04.2018 me vendim unanim,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret për pozicionin **Specialist Prokurimesh - Inxhinier në Sektorin e Prokurimeve në Drejtorinë Shërbimeve Mbështetëse 1** (një vend i lirë) si më poshtë:

Lloji i diplomës "Arsim i Lartë" niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"

Specialist Prokurimi/Inxhinier në Sektorin e Prokurimeve në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

- Paga e grupit sipas nivelit arsimor universitar;
- Shtesë mbi pagën e grupit për vjetërsi në punë në masën 2% për çdo vit pune;
- Kategoria e pagës IV-a.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Është përgjegjës për realizimin korrekt të procedurave të prokurimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar afatet e parashikuara në ligj dhe njëkohësisht standardet më të larta të transparencës ndaj publikut për një menaxhim sa më efektiv të fondeve;
2. Është përgjegjës për dhënien e këshillave, udhëzimeve dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor në fushën e prokurimit publik, me qëllim zbatimin me saktësi të dispozitave ligjore në fuqi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor", në fushën e inxhinierisë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Të kenë eksperiencë pune në profesion jo më pak se 3 vjet.
- Të kenë eksperiencë në fushën e prokurimit jo më pak se 3 vjet.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dërgojnë pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë për këtë pozicion;
- Jetëshkrim/ C.V;
- Kopje të noterizuar të diplomës dhe të listës së notave.
- Kopje të noterizuar të diplomës/ve Master dhe listës së notave.
- Kopje të noterizuar të librezës së punës;
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, lëshuar nga Gjykata dhe Prokuroria.
- Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, në lidhje me eksperiencën në punë/jo skualifikues;
- Dëshmi të noterizuara të kualifikimeve;
- Dëshmi të noterizuara të njohjes së gjuhës së huaj dhe përdorimit të kompjuterit.
- Deklaratë e kandidatit për mos pasjen e konfliktit të interesit dhe nepotizëm me personelin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, që shkarkohet në faqen e U.V;

Dokumentat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën: Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Zyra e protokollit me shënimin "*Për procedurën e konkurrimit për specialist prokurimesh/inxhinier në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.*"

Aplikantët të cilët i dorëzojnë dokumentat të pa noterizuara, ose kanë mangësi në dokumentacion skualifikohen menjëherë dhe nuk i nënshtrohen fazës së dytë.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

- a) Njohuritë mbi ligjin nr.80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*;
- b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*.
- c) Njohuritë mbi të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar;
- d) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*.
- e) Njohuri mbi ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999, *"Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"*, i ndryshuar.
- f) Njohuri mbi ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* ndryshuar;
- g) Njohuritë mbi Vendimin nr. 914 datë 29.12.2014 i Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar
- h) Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 1, datë 21.04.2016 i Këshillit të Ministrave *"Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.3 datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël"*;

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen me sistem pikëzimi për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe çertifikatat që vërtetojnë aftësinë, cilësi si dhe përvojë e tyre. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

2. Të miratojë kriteret për pozicionin Specialist Audit/ekonomist në Sektorin e Auditit
1 (një vend i lirë) si më poshtë:

Lloji i diplomës "Arsim i Lartë" niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"

Specialist Audit/ekonomist në Sektorin e Auditit

- Paga e grupit sipas nivelit arsimor universitar;
- Shtesë mbi pagën e grupit për vjetërsi në punë në masën 2% për çdo vit pune;
- Kategoria e pagës IV-a.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Ushtron në mënyrë të pavarur funksionin e auditit të brendshëm pa lënë hapsirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikqyrësit, drejtuesit e njësive së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjellta të këshillimit;
2. Kërkon dhe siguron të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik, financiar, menaxherial dhe ligjor të njësive që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre sipas legjislacionit në fuqi;
3. Merr nga punonjësit e njësive së audituar për rastet kur gjykohet e nevojshme shpjegime, deklarata, fotokopje të dokumentave, në të cilat titullari i njësive publike të audituar ka vënë shënimin "e njejtë me origjinalin" si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që janë subjekt i auditimit të brendshëm.
4. Ndjek në mënyrë periodike trajnimin e vijueshëm profesional.
5. Merr pjesë në grupe auditimi të miratuara nga drejtuesi i Sektorit të auditimit.

KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca ekonomike. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion.
- c) Të jenë të paisur me dëshminë "Auditues i brendshëm në sektorin publik".
- d) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dërgojnë pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë për këtë pozicion;
- Jetëshkrim/ C.V;
- Kopje të noterizuar të diplomës dhe të listës së notave.
- Kopje të noterizuar të diplomës/ve Master dhe listës së notave.
- Kopje të noterizuar të librezës së punës;
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, lëshuar nga Gjykata dhe Prokuroria.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

- Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, në lidhje me eksperiencën në punë/jo skualifikues;
- Dëshmi të noterizuara të kualifikimeve;
- Dëshmi të noterizuara të njohjes së gjuhës së huaj dhe përdorimit të kompjuterit.
- Deklaratë e kandidatit për mos pasjen e konfliktit të interesit dhe nepotizëm me personelin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë;

Dokumentat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën: Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Zyra e protokollit me shënimin "*Për procedurën e konkurimit për specialist audit/ekonomist në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.*"

Aplikantët të cilët i dorëzojnë dokumentat të pa noterizuara, ose kanë mangësi në dokumentacion skualifikohen menjëherë dhe nuk i nënshtrohen fazës së dytë.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*";
- Njohuritë mbi ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*".
- Njohuritë mbi Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr 100/2016 të Ministrit të Financave.
- Njohuritë mbi ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9228, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar,
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*".
- Njohuritë mbi të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- Njohuri mbi ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", i ndryshuar.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen me sistem pikëzimi për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe certifikatat që vërtetojnë aftësinë, cilësinë si dhe përvojë e tyre.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- A) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- B) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- C) Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

- 3. Të miratojë kriteret për pozicionin Specialist Audit/Jurist në Sektorin e Auditit**
1 (një vend i lirë) si më poshtë:

Lloji i diplomës "Arsim i Lartë" niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"

Specialist Audit/ekonomist në Sektorin e Auditit

- Paga e grupit sipas nivelit arsimor universitar;
- Shtesë mbi pagën e grupit për vjetërsi në punë në masën 2% për çdo vit pune;
- Kategoria e pagës IV-a.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Ushtron në mënyrë të pavarur funksionin e auditit të brendshëm pa lënë hapsirë për ndërhyrje nga kolegët, mbikqyrësit, drejtuesit e njësisë së auditimit apo pala e audituar, me përjashtim të marrëdhënieve të ndërsjellta të këshillimit;
2. Zbaton programin e auditimit.
3. Kërkon dhe siguron të gjitha të dhënat me karakter teknik, ekonomik, financiar, menaxherial dhe ligjor të njësisë që auditohet, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë së tyre sipas legjislacionit në fuqi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

4. Auditon dhe verifikon veprimet individuale brenda sistemeve të testuara nëpërmjet vlerësimit të riskut dhe punës në terren.
5. Mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat e siguruar nga puna audituese dhe harton raporte informuese për organet kolegjiale në mënyrë të pavarur, të pa-anshme dhe profesionale.
6. Organizon punën për rishikimin e kuadrit ligjor dhe procedural si dhe për udhëheqjen metodologjike të auditimit të brendshëm;
7. Shqyrton propozimet e njësive publike për rishikime apo ndryshime në manualet specifike apo udhëzime të tjera të fushës;
8. Merr nga punonjësit e njësisë së audituar për rastet kur gjykohet e nevojshme shpjegime, deklarata, fotokopje të dokumentave, në të cilat titullari i njësisë publike të audituar ka vënë shënimin "e njëjtë me origjinalin" si dhe materiale të transportueshme, në formë elektronike, që janë subjekt i auditimit të brendshëm.
9. Ndjek në mënyrë periodike trajnimin e vijueshëm profesional.
10. Merr pjesë në grupe auditimi të miratuara nga drejtuesi i Sektorit të auditimit.

KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- e) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- f) Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion.
- g) Të jenë të paisur me dëshminë "Auditues i brendshëm në sektorin publik".
- h) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dërgojnë pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë për këtë pozicion;
- Jetëshkrim/ C.V;
- Kopje të noterizuar të diplomës dhe të listës së notave.
- Kopje të noterizuar të diplomës/ve Master dhe listës së notave.
- Kopje të noterizuar të librezës së punës;
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, lëshuar nga Gjykata dhe Prokuroria.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

- Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, në lidhje me eksperiencën në punë/jo skualifikues;
- Dëshmi të noterizuara të kualifikimeve;
- Dëshmi të noterizuara të njohjes së gjuhës së huaj dhe përdorimit të kompjuterit.
- Deklaratë e kandidatit për mos pasjen e konfliktit të interesit dhe nepotizëm me personelin e Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë;

Dokumentat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën: Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë, Zyra e protokollit me shënimin "*Për procedurën e konkurimit për specialist audit/Jurist në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë.*"

Aplikantët të cilët i dorëzojnë dokumentat të pa noterizuara, ose kanë mangësi në dokumentacion skualifikohen menjëherë dhe nuk i nënshtrohen fazës së dytë.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*";
- Njohuritë mbi ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*".
- Njohuritë mbi Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr 100/2016 të Ministrit të Financave.
- Njohuritë mbi ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9228, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar,
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*".
- Njohuritë mbi të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- Njohuri mbi ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", i ndryshuar.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen me sistem pikëzimi për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse si dhe certifikatat që vërtetojnë aftësinë, cilësinë si dhe përvojë e tyre.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- D) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- E) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- F) Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

4. Afati i aplikimit është si më poshtë:

Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentave është 14 ditë, nga dita e publikimit të njoftimit në Web-site të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

5. Procedura që duhet të ndiqet është si më poshtë:

- *Pas njoftimit të procedurës së punësimit, Rektori urdhëron ngritjen e komisionit ad-hoc pranë rektoratit për përzgjedhjen e personelit administrativ. Komisioni do të kryesohet nga Administratori dhe do të ketë në përbërje Drejtorin e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtorin e drejtorisë përkatëse ku do të punësohet aplikanti.*
- *Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, por jo më vonë se 2 (dy) ditë, Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, merr në dorëzim gjithë dosjet e kandidatëve dhe i a përcjell komisionit listën e kandidatëve me dokumentacionin përkatës.*
Në datën 18.05.2018, Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore do të njoftojë kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, për datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista në numrin personal të telefonit të deklaruar dhe adresën e-mail-it të deklaruar prej tyre, .
- *Skema e vlerësimit hartohet me vendim të Komisionit ad-hoc dhe miratohet nga Rektori.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

- *Vlerësimi i mësipërm kryhet nga çdo anëtar i Komisionit ad-hoc për secilin kandidat. Në përfundim, mbliidhen pikët e dhëna nga anëtarët e Komisionit për të njëjtin kandidat dhe hartohet klasifikimi paraprak.*
- *Pas vlerësimit paraprak kryhet intervista me kandidatët e klasifikuar, të cilët njoftohen në numrin personal të telefonit të deklaruar dhe adresën e-mail-it të deklaruar prej tyre, nga Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës.*
- *Komisioni ad-hoc vëzhgon dhe vlerëson performancën e komunikimit dhe njohuritë e kandidatëve sipas kriterëve përkatëse të vendit të punës të kandidatëve dhe i vlerëson ata me pikë, sipas sistemit të pikëzimit .*
- *Komisioni ad-hoc plotëson pasqyrën përmbledhëse të rezultateve të konkurimit në të dy fazat dhe së bashku me gjithë dokumentacionin përkatës dhe i a përcjellin Rektorit.*
- *Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore bën njoftimin e kandidatëve fitues dhe atyre që nuk përzgjidhen (jo fitues).*
- *Kandidatët jo fitues kanë të drejtën e ankimit tek Rektori brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të komisionit.*
- 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 7. Ngarkohet Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore të bëjë shpalljen për konkurim të hapur për pozicionet e mësipërme në web-site e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.

Dr. Rezana Vrapit – Kryetar

Florian Nurçe – anëtar

Eduard Ahmeti- anëtar

Dr. Enida Pulaj – anëtar

Dr. Elsjed Rexhaj – anëtar

Dr. Marinela Muço – anëtar

Ornela Koleka - anëtar